

RREGULLORJA E PUNËS SË BORDIT

Rregullorja e punës së Bordit të "Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuar" HandiKos-Ferizaj, Shkurtesa Sh.P.A.K - HKFR

Me këtë Rregullore, të miratuar në mbledhjen e Bordit të datës 13.05.2017, përcaktohen mënyra e punës dhe e marrjes së vendimeve në mbledhjet e Bordit të Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuar" HandiKos- Ferizaj, Shkurtesa Sh.P.A.K - HKFR

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohen mënyra e punës dhe e marrjes së vendimeve në Bordin e "Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuar" HandiKos- Ferizaj, që konsistojnë në:

Bordi do të ketë këto përgjegjësi:

Bordi konsultativ ka një rol të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes në organizata. Ja disa nga funksionet kryesore të bordit konsultativ:

1. **Këshillim dhe Orientim:** Ofron këshilla dhe rekomandime për strategji dhe politika që ndihmojnë në arritjen e objektivave të organizatës.
2. **Ekspertizë:** Anëtarët e bordit sjellin njohuri dhe përvojë nga fusha të ndryshme, duke ndihmuar në zgjidhjen e problemeve komplekse.
3. **Marrëdhënie Publike:** Ndihmojnë në ndërtimin e marrëdhënieve me palët e interesuara dhe mund të përfaqësojnë organizatën në ngjarje dhe aktivitete të ndryshme.
4. **Vlerësim dhe Monitorim:** Mund të ndihmojnë në vlerësimin e rezultateve dhe performancës së projekteve dhe programeve, duke siguruar që ato përputhen me standardet e pritura.

Neni 2

Mbledhjet e rregullta të Bordit mbahen të paktën një herë vit.

Neni 3

Në mbledhjet e Bordit, përveç anëtarëve, mund të marrin pjesë edhe anëtarët e Këshillit mbikëqyrës pa të drejtë pjesëmarrjeje në marrjen e vendimeve.

II. PËRGATITJA DHE KONVOKIMI I MBLEDHJEVE TË BORDIT

Neni 4

Mbledhjet e Bordit i thërret kryetari i Bordit.

RREGULLORJA E PUNËS SË BORDIT

Neni 5

Mbledhjet e Bordit mund të mbahen nëse në to marrin pjesë më tepër se gjysma e anëtarëve, ndërsa vendimet dhe konkluzat do të jenë të vlefshme nëse për to votojnë më tepër se gjysma e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Neni 6

Mbledhjet e Bordit i përgatisin Drejtori dhe kryesuesi i kuvendit të anëtarëve, ndërsa i udhëheq Kryesuesi, të cilin e autorizon kryetari apo Bordi.

Neni 7

Me rastin e hapjes së mbledhjes, kryesuesi propozon rendin e ditës.

Neni 8

Çdo anëtar ka të drejtë të propozojë ndryshimin apo plotësimin e rendit të ditës, duke dhënë arsyetimet përkatëse, ndërsa rendin përfundimtar e miraton Bordi.

III. VENDIMET DHE KONKLUZAT

Neni 9

Pas çdo pike të rendit të ditës Bordi merr vendime apo konkluzat përkatëse.

Neni 10

Vendimet në Bord merren me shumicë votash.
Votimet në mbledhjet e Bordit janë të hapura.

Neni 11

Vendimet dhe konkluzat e marra shënohen në procesverbal.

Neni 12

Për tërë rrjedhën e mbledhjes së Bordit mbahet procesverbali, të cilin në fund të mbledhjes e nënshkruajnë kryetari i bordit ose kryesuesi i mbledhjes dhe procesmbajtësi.

V. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 13

RREGULLORJA E PUNËS SË BORDIT

Rregullorja e punës së Bordit miratohet nëse për të votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve të Bordit, ndërsa ndryshimet dhe plotësimet e saj bëhen në mënyrën dhe sipas procedurës së njëjtë sikurse miratimi i saj.

Neni 14

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga anëtarët e "Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuar" HandiKos- Ferizaj.

Më Datë 13.05.2017.

Kryesues/e e Kuvendit



Valdete Zekolli